



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 13.01.2017

Vendim
Nr. 03, datë 13.01.2017

**PËR PËRZGJEDHJEN DHE EMËRIMIN E PERSONELIT AKADEMIK ME
KONTRATË ME KOHËZGJATJE TË CAKTUAR, ME ANGAZHIM TË
PLOTË, NË FUNKSION TË NEVOJAVE TË MËSIMDHËNIES DHE
PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE INSTITUCIONALE PËR EFEKT TË
PROCESIT TË AKREDITIMIT**

Në mbështetje të pikës 1, të pikës 4, shkronja ç të nenit 3 dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 64 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", të rekomandimeve të MAS për organigramën e fakulteteve dhe departamenteve (Raporti i Inspektimit nr. 5265 prot., datë 01.08.2014) dhe nevojave urgjente për personel akademik, në funksion të përmbushjes së standardeve institucionale dhe mësimdhënies, Senati akademik

VENDOSI:

1. Departamentet që kanë nevoja urgjente për personel akademik, për efekt të përmbushjes së standardeve institucionale dhe mësimdhënies, të propozojnë për punësim, personel akademik (doktorantë ose jo), nga kontigjenti që ka aplikuar për vende të lira pune në UV dhe është renditur në tabelat e pikëzimit nga komisionet *ad-hoc*, por nuk është shpallur kandidat fitues, për shkak të mosplotësimit të ndonjë kriteri specifik.
2. Kontratat e këtij grupi personeli të jenë të vlefshme nga pikëpamja ligjore e juridike vetëm për periudhën 1 (një) vjeçare, (kontrata me kohëzgjatje të caktuar, me angazhim të plotë).
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Rektori, dekanët, drejtuesit e njësive bazë, Kancelari, Drejtoria e Financave dhe Buxhetit si dhe Sektori i Burimeve Njerëzore.
4. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. Ky vendim ka vlerë vetëm për vitin akademik aktual.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.